



---

**BURSA STUDIMI UNIVERSITARE / PASUNIVERSITARE NË KINË,  
VITI AKADEMIK 2018-2019**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës Popullore e Kinës për vitin akademik 2018-2019 ofron 3 (tre) bursa të plota për studime universitare ose pasuniversitare për në universitetet publike të Kinës, konkretisht:

- 1 (një) bursë për studime universitare ose pasuniversitare në një fushë të caktuar interesi;
- 2 (dy) bursa për studime universitare ose pasuniversitare për shkenca mjekësore, në kuadër të Programit për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEC).

Lidhur me këto bursa studimi, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë dokumentet, sipas listës në vijim:

Për studime universitare:

1. Kërkesën për studime universitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore;
3. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit (jo më shumë se 200 fjalë);
4. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku kandidati ka studiuar;
5. Çertifikata të ndryshme (fotokopje) për pjesëmarrje në konkurse ose olimpiada në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi sipas modelit të palës kineze, kopje bashkëlidhur *Foreigner Physical Examination Form*;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
8. 4 fotografi

Për studime pasuniversitare:

1. Kërkesën për studime pasuniversitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku kandidati ka studiuar;
3. Kopjet e noterizuara të diplomave ose të dokumenteve të ngjashëm që vërtetojnë mbarimin e programeve të studimit të nivelit të parë (bachelor)/ të nivelit të dytë (master);
4. Kopjen e noterizuar të Supplementit të Diplomës Bachelor/Master;

5. Listën e notave;
6. 2 letra rekomandimi nga profesorë të universitetit ose nga titullarë të vendit të punës në rast se kandidati është i punësuar;
7. Letrën e interesit ose një plan studimi për programin e studimit (deri në 800 fjalë);
8. Raportin mjekësor për aftësi studimi sipas modelit të palës kineze, kopje bashkëlidhur *Foreigner Physical Examination Form*;
9. Fotokopjen e faqes të pasaportës me të dhënat e identitetit;
10. 4 fotografi

Për programet e studimit në muzikë ose artet e bukura, kandidatët duhet të kenë në dokumentacion një CD me interpretimet ose punimet e tyre (dy skeçe, dy piktura me ngjyra, etj).

Afati i fundit për dorëtimin e dokumenteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit do të jetë data **12 mars 2018**.

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë do të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë që plotësojnë kushtet e aplikimit për bursat e ofruara nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës.

Krahas procedurës për sa më sipër, kandidatët fitues, të cilët do të përzgjidhen nga MASR për këto bursa studimi, duhet të përfundojnë gjithashtu, procedurën e aplikimit online deri në datën **01 Prill 2018** (afati i fundit) në linkun: <http://www.csc.edu.cn/studyinchina>

Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, tarifën e shkollimit dhe siguracionin shëndetësor. Ndërsa shpenzimet udhëtimit duhet të mbulohen nga vetë kandidatët.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialeve informativë (bashkëlidhur) dhe adresave në web-site:

<http://www.csc.edu.cn/laihua;>

<http://www.csc.edu.cn/studyinchina/newsdetailen.aspx?cid=66&id=3074;>

[www.campuschina.org;](http://www.campuschina.org)

<http://en.csc.edu.cn/Laihua/newsdetailen.aspx?cid=66&id=3074;>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**